



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, për qëllimin e sigurimit të tokës për interes publik- ndërtimin e shkollës fillore sipas PRRU “ Dheu i Bardh-2”, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur me date 29.02.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të objektit arsimor- shkollë fillore sipas PRRU “Dheu i Bardh-2” – Gjilan

1. Kuvendi i Komunës Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të sigurimit të tokës për interes publik- objektit arsimor – shkollë fillore të paraparë me PRRU “ Dheu i Bardh-2” , Zona Kadastrale Gjilan.
2. Lejohet këmbimi i ngastrave kadastrale:
 - a) P-70403013-00296-6, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 314 m², te vendi i quajtur “Poredin”, lloji i shfrytëzimit – bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës – arë e kl.1, e cila evidentohet në emër të pronares Fatmire (Adem) Shabani, me 1/1 të pjesës së pronës, ZK-Gjilan;
 - b) Me pjesën e ngastrës kadastrale : P-70403013-00001-29, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, lloji i pronës- prone shoqërore, me sipërfaqe prej 24539 m², te vendi i quajtur “Gllama”, lloji i shfrytëzimit – bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës – kullosat e kl.4 , e cila evidentohet në emër të pronarit P.Sh.Kuvendi i Komunës -Gjilan, me 1/1 të pjesës së pronës, ZK-Gjilan;
3. Pronat e përshkruara në pikën II të këtij Vendimi janë të përfshira me Planet Rregulluese Urbane “ Dheu i Bardh-1” dhe “Dheu i Bardh-2” dhe këmbimi i këtyre pronave bëhet në përputhje me këto plane, sipas destinimit të paraparë .
4. Obligohet Kryetari i Komunës, që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronarin privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrës Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe pas lidhjes së kontrates mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronave të këmbyera në Regjistrat Kadastral.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-19975

Gjilan, më 29.02.2016

Kryesuesja e Kuvendit,

/Valentina Bunjaku –Rexhepi/